



# Buletini i Turizmit

*Raportim Mujor*

**Korrik 2019**

# **PËRMBAJTJA**

## **HYRJE**

- 1. VIZITORË TË HUAJ TË HYRË PËR MUAJIN KORRIK 2019..... fq.3**
  - 1.1. Hyrjet e shtetasve të huaj sipas shteteve**
  - 1.2. Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit**
  - 1.3. Hyrja e shtetasve të huaj sipas mënyrës së udhëtimit**
  
- 2. TURIZMI KULTUROR.....fq.6**
  
- 3. TURIZMI NATYROR..... fq.7**

## 1 HYRJET E VIZITORËVE TË HUAJ PËR MUAJIN KORRIK 2019

Në muajin Korrik 2019, sipas INSTAT, kanë hyrë 1.176.810 shtetas të huaj në vend. E krahasuar me muajin Korrik 2018, hyrjet për këtë muaj janë rritur prej 14,5%. Nga periudha Janar- Korrik 2019, numri i vizitorëve të huaj ka arritur në 3,313,762 mijë, duke u rritur me 12,4 % në krahasim me të njëjtën periudhë kohore të viti 2018.

Periudha	Korrik 2018	Korrik 2019	Ndryshimi në (%)	Jan-Korr 2018	Jan-Korr 2019	Ndryshimi në (%)
Vizitorët e huaj	1,028,182	1,176,810	14,5	2,947,686	3,313,762	12,4

Burimi INSTAT

### 1.2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Referuar qëllimit që deklarojnë shtetasit e huaj, që vizitojnë Shqipërinë, rezultoi se gjatë muajit Korrik kemi një rritje prej 14,5 % për ata që kanë deklaruar se kanë ardhur për qëllime pushimesh. Rritje të kosiderueshme kanë vizitorët që kanë ardhur për arsye shëndetësore dhe biznes.

Më poshtë është tabela e vizitorëve të huaj sipas qëllim të vizitës së tyre, që deklarojnë në pikat tona kufitare për muajin korrik si dhe për shtatëmujorin e parë të vitit:

Periudha	Korrik 2018	Korrik 2019	Ndryshimi (%)	Jan-Korr 2018	Jan-Korr 2019	Ndryshimi (%)
Gjithsej	1.028.182	1.176.810	14,5	2.947.687	3.313.762	12,4
I. Personale	1.020.381	1.167.708	14,4	2.899.066	3.257.196	12,4
Pushime, miq e të afërm. Te tjere	985.913	1.128.573	14,5	2.785.334	3.130.502	12,4
Trajtim shëndetësor	19	24	26,3	139	468	236,7
Qëllime fetare	111	66	-40,5	519	531	2,3
Tranzit	34.338	39.045	13,7	113.074	125.695	11,2
II. Biznes dhe profesionale	7.801	9.102	16,7	48.621	56.566	16,3

Burimi INSTAT

### 1.3 Hyrja e shtetasve të huaj sipas mënyrës së udhëtimit

Hyret e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Korrik 2019 janë 1.724.374, krahasuar me Korrik 2018 ky tregues rezulton me rritje 11.4%.

Në shtatëmujorin e parë të 2019 kanë hyrë gjithsej në pikat tona kufitare 6.325.880 shtetas të huaj dhe shqiptarë, hyrjet për këtë periudhë kohore gjashtëmujore janë rritur 10.2% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraardhës.

Gjatë muajit Korrik po dhe nga të dhënat për shtatëmujorin e parë vihet re një rritje e numrin e udhëtarëve që zgjedhin avionët si mënyrë udhëtimi, kemi një rritje prej 12,7% të udhëtarëve të krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2018.

Vijon që vlera më e lartë të jetë për udhëtarët që përdorin mjete tokësore, ky lloj udhëtimi ka njohur rritje në masën 12.3% krahasuar me të njëjtin muaj të vitit parardhës.

Në tabelën më poshtë jepet lloji i udhëtimit të shtetasve të huaj dhe shqiptarë, që kanë zgjedhur gjatë muajit korrik 2019, krahasuar kjo me të njëjtin muaj të vitit 2018. Gjithashtu gjenden të dhënat për shtatëmujorin e vitit 2019, për llojin e udhëtimit të zgjedhur nga shtetasit e huaj dhe shqiptarë për të hyrë në Shqipëri, krahasuar me shtatëmujorin e 2018:

Nr.	Mënyra e udhëtimit	Periudha					
		Korrik 2018	Korrik 2019	Ndryshimi në %	Jan-Korr 2018	Jan-Korrik 2019	Ndryshimi në %
1	Me ajër	190.807	215.019	12,7	834.790	923.679	10,6
2	Me det	152.042	155.494	2,3	380.417	417.302	9,7
3	Me tokë	1.205.755	1.353.861	12,3	4.522.960	4.984.899	10,2

#### Burimi INSTAT

Në lidhje me raportin e mënyrës së transportit të zgjedhur nga vizitorët e huaj për të hyrë në Shqipëri në muajin Korrik 2019 me numrin e hyrjeve në total të vizitorëve të huaj dhe vendas, i shprehur në %, është si më poshtë:

- i. 78,5 % e të huajve dhe vendasve që zgjedhin rrugën tokësore për të hyrë në Shqipëri;
- ii. 12,5% e të huajve dhe vendasve që hyjnë në kufirin shqiptar në rrugë ajrore;

iii. 9 % e hyrjeve bëhet nëpërmjet transportit detar.

#### 1.4 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas shteteve

Në muajt e fundit vihet re një rritje e vizitorëve me nënshtetësi angleze në një masë prej 17,3% krhasuar me të njëjtin muaj të vitit 2018. Më pas vijon rritja më e madhe për shtetasit me pashaporta zviceriane e gjermane.

Gjithsesi shtetasit kosovarë kryesojnë me numrin më të madh të vizitorëve të huaj që vizitojnë vendin tonë. Ata zënë 38% të totalit të vizitorëve gjatë muajit Korrik 2019.

Më poshtë gjeni tabelën krahasuese të hyrjes së vizitorëve të huaj për nga shtetësia:

Shtetet	Korrik 2018	Korrik 2019	Ndryshim i (%)	Jan-Korrik 2018	Jan-Korrik 2019	Ndryshim i (%)
<b>Kosovë</b>	357.588	448.896	25,5	929.831	1.057.545	13,7
<b>Maqedoni</b>	97.820	95.457	-2,4	360.359	372.444	3,4
<b>Greqi</b>	54.379	60.272	10,8	287.233	311.773	8,5
<b>Itali</b>	59.933	64.530	7,7	145.443	159.177	9,4
<b>Angli</b>	21.942	25.738	17,3	205.376	223.707	8,9
<b>Mali i Zi</b>	25.220	25.359	0,6	210.944	215.595	2,2
<b>Poloni</b>	43.302	36.991	-14,6	84.926	75.965	-10,6
<b>SHBA</b>	23.755	23.708	-0,2	66.656	72.518	8,8
<b>Gjermani</b>	25.560	29.402	15,0	75.328	88.888	18,0
<b>Zvicër</b>	18.850	21.962	16,5	32.813	40.759	24,2
<b>Spanjë</b>	4.595	4.413	-4,0	11.995	13.660	13,9

**Burimi INSTAT**

## 2. TURIZMI KULTOROR

Gjatë muajit Korrik në institucionet tona kulturore k një rritje prej 9% krahasuar me të njëjtën muaj të 2018. Më poshtë gjeni në mënyrë më të detajuar numrin e vizitorëve të ndara sipas institucioneve kulturore.

Nr.	EMËTIMI I INSTITUCIONIT	Korrik		Rritja ne %
		2018	2019	
1	MUZEU HISTORIK KOMBËTAR TIRANË	6,025	7,837	30
2	MUZEU ARKEOLOGJIK DURRËS	1,714	2,665	55.5
3	MUZEU I PAVARSISË VLORË	339	360	6.2
4	MUZEU GJERGJ KASTRIOTI, KRUIJË	7,840	8,364	6.7
5	MUZEU ETNOGRAFIK, KRUIJË	3,115	3,448	10.7
6	MUZEU ETNOGRAFIK BERAT	1,084	1,282	18.3
7	MUZEU IKONOGRAFIK ONUFRI, BERAT	5,734	5,618	-2
8	MUZEU I ARTIT MESJETAR, KORÇË,	608	549	-9.7
9	MUZEU ARKEOLOGJIK, KORÇË,	82	53	-35.4
10	MUZEU ARSIMIT, KORÇË,	799	0	-100
11	MUZEU K. I FOTOGRAFISË MARUBI	1,634	1,646	0.73
12	MUZEU K. I PËRGJIMEVE " SHTËPIA ME GJETHE"	2,297	2,582	12.41
<b>TOTALI MUZE</b>		<b>31,271</b>	<b>34,404</b>	<b>10.02</b>
1	KALAJA BERAT	12,037	13,307	10.55
2	KALAJA GJIROKATËR	15,535	15,748	1.37
3	KALAJA PORTOPALERMOS	7,300	6,200	-15
4	KALAJA E KANINËS	400	650	62.50
5	KALAJA E HIMARËS	815	600	-26.4
6	AMFITEATRI	2,287	2,641	15.5
7	MANASTIRI I 40 SHËNJTORËVE	120	293	144

<b>8</b>	MANASTIRI I MESOPOTAMIT	0	1,228	100%
<b>TOTALI KALA E MONUMENTE TE TJERE</b>		<b>38,494</b>	<b>40,667</b>	5.6
<b>1</b>	PARKU KOMBËTAR BUTRINT	43,260	46,506	7.5
<b>2</b>	PARKUT ARKEOLOGJIK APOLONI	5,698	5,918	3.9
<b>3</b>	PARKU ARKEOLOGJIK BYLIS	220	429	95
<b>4</b>	PARKU ARKEOLOGJIK SHKODËR	13,619	16,548	21.5
<b>5</b>	PARKU ARKEOLOGJIK LEZHË	435	659	51.5
<b>6</b>	PARKU ARKEOLOGJIK AMANTIA	45	70	55.6
<b>7</b>	PARKU ARKEOLOGJIK ORIKUM	321	501	56.1
<b>8</b>	PARKU ARKEOLOGJIK FINIQ	104	122	17.3
<b>9</b>	PARKU ARKEOLOGJIK ANTIGONE	185	50	-73
<b>TOTALI PARQE ARKEOLOGJIK</b>		<b>63,887</b>	<b>70803</b>	10,8
		<b>133,652</b>	<b>145874</b>	9,1

Burimi Ministria e Kulturës

Në lidhje me të ardhurat nga vizitorët në Institucionet Kulturore për muajin Korrik rezultojnë që është përfituar vlera prej 37,335,920 Lek. Vlera e arkëtuar është rreth 3 milion e 358 mijë lek më shumë se vlera e përfituar nga i njëjti muaj i një viti më parë pra 10% më shumë.


### 3. TURIZMI NATYROR

Të dhënat nga Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, tregojnë se gjatë muajit Korrik 2019 ka pasur 937,477 vizitorë vendas dhe të huaj në zonat e administruara nga kjo Agjensi. Numri i vizitorëve vendas zë 71% të numrit total të vizitorëve në këto site natyrore.

Gjithashtu numri i vizitorëve të huaj, që kanë vizituar zonat tona të mbrojtura në Korrik 2019 kanë një rritje prej 9,3 % krahasuar me të njëjtit muaj në 2018. Të ardhurat e mbledhura gjatë muajit korrik 2019 nga vizitorët në zonat e mbrojtura është në vlerën 2,307,950 Lek.

	Korrik 2018	Korrik 2019	Rritja në %
Vizitorë në ZM (total)	857,459	937,477	9.3
Vendas	559,221	666,622	19,2
Të huaj	298,238	270,855	-9.1

Më poshtë po japim një grafik të zonave më të preferuara prej vizitorëve në rang qarku, krahasuar me të njëjtin muaj të vitit të shkuar.



**Tab 6. Burimi Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura**